

PKR.nr.615/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – Kryetarja e trupit gjykues Shadije Gërguri me procesmbajtësin Arianit Mahmutaj në lëndën penale ndaj të akuzuarit E.H për shkak të veprës penale Përdorimi i armës nga neni 375 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.841/2014 të datës 26.10.2015, pas mbajtes së shqyrtimit fillestar, verbal e publik me dt: **18.07.2017** në prezencën e të akuzuarit E.H, dhe prokurorit të shtetit Armend Hamiti, të njëjtën ditë bjenë e në prezencë të palëve publikisht shpallë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

E.H nga i ati R dhe e ema M, e vajzerise S, i lindur me *data e lindjes* në P, me vedbanim në f.sh. K K-P, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i tre fëmijëve, I punësuar në M në T, gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr personal: *numer personal*

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: I pandehuri me dt: 10.08.2014, rreth orës 19:00 në fshatin K K-P, gjatë ahengut familjarë ka përdorur armën – pushkën automatike, m nr. serik 4205600 dhe një karikator, në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm në lidhje me armën e tillë, të cilën armë e kishte poseduar pa lejen e organeve kompetent,-

-me çka ka kryer veprën penale: Përdorimi i armës nga neni 375 par.1 të KPK-së

Andaj gjykata me aplikimin e neneve: 3,41,42,43,49,50,51.52,62,73,të KPRK-së dhe nenit 365 dhe 450 të KPPRK-së.

Të akuzuarit **E.H** për veprën penale Përdorimi i armës nga neni 375 par.1 të KPK-së, i shqiptoi **DENIM ME KUSHT – DENIM BURGU**, në kohëzgjatje prej **gjashtë (6)**

maujë, i cili denim nuk do të ekzekutohet, nese i gjykuari nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, në periudhë kohore prej **një (1) viti**.

MBI DENIMIN PLOTËSUES

Konform nenit 62 par.2 nën.par.2.7 të KPK-së ndaj të akuzuarit E.H konfiskohet arma automatike AK47, me nr serik 4205600 dhe një (1) karikator i zbrazët, te cilat janë sekuestruar nga ana e policisë si mjete për kryerjen e veprës penale , dhe të njejtat të shkatrohen pas plotëfuqëshmërisë së aktgjykimit

MBI SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE DHE PAUSHALLIN GJYQËSOR

I gjykuari E.H obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej nga **30 € (tridhjet) Euro**, në afat prej 15 (pesëmbëdhjet) ditësh nga dita e plotëfuqëshmërisë të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda ka ngritur aktakuzë PP/I.nr.841/2014 të datës 26.10.2015, kundër të akuzuarit E.H për shkak të veprës penale Përdorimi i armës nga neni 375 par.1 të KPK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestarë me datën 18.07.2017 dhe pasi që i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 246 të KPPRK-së, I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, nuk ka nevojë për sçarim shtesë dhe pasi i ipet mundësia që të pranoj, ose mos te pranoj fajësinë lidhur me veprën penale që i vëhet në barrë, i akuzuari në kuptim të nenit 248 të KPPRK-së, deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën e ngarkon aktakuza nga ana e prokurorisë.

Prokurori i shtetit pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata e aprovoi pranimin e fajësisë pasi që u bind se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht dhe pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbanë aktakuza, në materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore , ose gabime faktike.

Duke marr parasysh se pranimi i fajësisë është arritur në shqyrtimin fillestarë konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së kur kryetari i trupit gjykues mundë të vazhdon procedurën me shqiptimin e denimit pa shkuar fare në shqyrtim gjyqësorë dhe pa e plotësuar trupin gjykues, gjykata pa fjalë përfundimtare, pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe pasi që bindet se janë vërtetuar faktet lidhur me pranimin e fajësisë, të njejtën ditë vazhdoi me shqiptimin e denimit, duke marr parasysh se i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje direkte, ka qenë i vetëdijshëm për veprën e tij dhe e ka dashur kryerjen e saj.

Me rastin e përcaktimit të denimit Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat letësuese dhe rëndësuese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e denimit, kështu që ndaj të akuzuarit morri parasysh pranimin e fajësisë dhe pendimin e thellë, ka të kryer shkollën

e mesme, i martuar, baba i tre fëmijëve, i punësuar në Minierë në Trepqë, gjendjes së dobët ekonomike. Nga rrethanat rëndësuese asgjë nuk gjeti. Andaj gjykata të njejtin e shpalli fajtorë dhe e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se denimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës dhe përgjegjësisë penale dhe më të njejtën do të arrihet qëllimi I denimit .

Gjykata është e bindur se me denimin e shqiptuar në tërësi do të arrihet qëllimi i denimit siç është rregulluar me nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi denimin plotësues është marrur konform nenit 62 par.2 nën.par.2.7 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësorë, është marr konform dispozitave të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPRK-së.

Nga sa u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.615/15, të dt. 18.07.2017

Procesmbajtësi,
Arianit Mahmutaj

Kryetarja e trupit - gjyqtarja,
Shadije Gërguri

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate